



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.04.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimeve nr. 125, datë 04.04.2019 dhe 136 e 137, datë 9.4.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në Qarqet Tiranë, Korçë dhe Dibër për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve z. Korab Lita, z. Arlind Çaçani dhe z. Halil Jakimi.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Ermonela Felaj, Vasilika Hysi, Myslym Murrizi, Besnik Bare.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Ulsi Manja, Klotilda Bushka,

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend edhe 3 vendimet nr. 125, datë 4.4.2019 dhe 136 dhe 137 datë 9.4.2019 për dhënien e mandatit të deputetit 3 kandidatëve të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në Qarqet Tiranë, Korçë dhe Dibër.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mblidhet për të bërë verifikimin e mandatit të deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës. Me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë fituar mandatin e deputetit, konkretisht:

- z. Korab Lita nga lista shumemërore e Partisë Demokratike Qarku Tiranë.
- z. Arlind Çaçani nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Korçë.
- z. Halil Jakimi nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Dibër.

Vendimet e Komisionit Qendror dhe drafraportin i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit në lidhje me mandatin e deputetëve të rinj?

Nuk ka.

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Atëherë, raporti i Këshillit do t'i kalojë seancës plenare për miratim!

Relatorja Znj. Klotilda Bushka do të lexojë raportin e përmbledhur.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA